



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 7 paragrafi 2, nenit 8, nenit 9 paragrafi 1 dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-212 për Financimin e Subjekteve Politike, nenit 1 paragrafi 2, nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullës nr. 14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, shpalljes së Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 31.10.2019 merr këtë :

V E N D I M

për plotësim të Vendimit 195/2019 mbi Caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2019

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lejon transferimin e fondeve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike vetëm deri në datën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 6 tetor 2019.
- II. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve autorizon transferimin e fondeve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike në baza mujore deri në datën certifikim të rezultateve.
- III. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve autorizon mbajtjen dhe kthimin në Buxhet të Kosovës të fondeve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike që janë paraparë për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet për periudhën deri në certifikimin të rezultateve.
- IV. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdetë Daka, Kryetare